



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 154 Datë 28.12.2020

“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare “

Në mbështetje të Ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “ për qeverisjen vedore”, Ligjit Nr.107 datë 22.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjit Nr.45 datë 18.07.2019 “ për mbrojtjen Civile”, VKM Nr.329 datë 16.05.2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore “ kreu III, pika 1, gërma ë, pika IV, Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e tij, datë 28.12.2020 miratoi me 18 vota pro 0 kunder 0 apstenim.

VENDOSI :

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 2 katëshe ( kati parë)** ne pronësi të **z.Remzi Deshati** njësia administrative Peshkopi (Lagj.Nazmi Rushiti), në shumën totale **400,467** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **202,267.lekë** dhe vlera e dëmit orëndiak **198,200.lekë**.
3. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **66744,5 leke** ( 30% e 50% të vlerës totale të dëmit ) per ti perdorur per riparimin e demit te shkaktuar.
4. Për pjesën tjetër të vlerës së patrajtuar, për pamundësi financiare, do të dërgohet dokumentacioni në Institucionin e Prefektit Qarkut Dibër për AKMC pranë Ministrisë Mbrojtjes Tiranë për kompensimin e vlerës së mbetur për trajtim nga program i “**Emergjencave Civile**”.
5. Ky vendim hynë në fuqi pas konfirmimit nga Institucini i Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmëri ligjore.

